



Republika e Kosovës

Republika Kosova ~ Republic of Kosovo

Qeveria ~ Vlada ~ Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta ~ Ministry of Culture, Youth & Sport

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE 2015-2025

**Draft për konsultim publik
Shtator 2015**

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
SHKURTESAT	1
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
2. HYRJE.....	5
3. METODOLOGJIA	6
4. SFONDI	7
5. VIZIONI, SYNIMET DHE OBJEKTIVAT	9
OBJEKTIVI 1: AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	10
OBJEKTIVI 2: QASJA E INTEGRUAR NË TRASHËGIMINË KULTURORE, DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM	12
OBJEKTIVI 3: PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANET ZHVILLIMORE	14
OBJEKTIVI 4: PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE.....	16
OBJEKTIVI 5: EDUKIMI, AFTËSIMI DHE PJESËMARRJA AKTIVE NË MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE	18
6. HAPAT E ARDHSHËM PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË	20
7. BIBLIOGRAFIA.....	23

SHKURTESAT

BE - Bashkimi Europian

DTK - Databaza e Trashëgimisë Kulturore

ESDP - Perspektiva e Zhvillimit Hapësinor Evropian

IPA - Instrument for Pre-accession Assistance

KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2018

KKTK - Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

KMZ-SKTK - Komiteti Monitorues për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2015-2025

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MSA - Marrëveshja për Stabilizim-Asociim

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik

SEE 2020 - Strategjia e Evropës Juglindore 2020 për Punësim dhe Prosperitet në Perspektivën Evropiane

UNESCO - United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

VNTK- Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore

VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2015-2025 është një strategji gjithëpërfshirëse e Qeverisë së Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore, e cila synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë. Ky dokument strategjik synon avancimin e sistemit dhe të mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombetare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Megjithë sfidat e shumta në këtë drejtim, të trashëguara dhe aktuale, angazhimi i vazhdueshëm i MKRS dhe institucioneve relevante në fushën e trashëgimisë kulturore ka bërë që kjo të kthehet në prioritet qeveritar.

Me këtë Strategji, trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, që do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes efektive në avancimin e sistemit të mbrojtjes. Në të adresohen aspektet themelore që në mënyrë të drejtpërdrejtë synojnë hapjen e perspektivës për promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës, si dhe rritjen e dukshmërisë së potencialit të saj si vlera kombëtare dhe universale. Synimet e Strategjisë mund të përmbledhen si në vijim:

[i] Sistemi ligjor dhe institucional i mbrojtjes - në përputhje me orientimin e Qeverisë së Kosovës karshi Prioriteteve të Partneritetit European dhe anëtarësimit në UNESCO;

[ii] Qasja e integruar në mbrojtje - sipas parimeve dhe trendeve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor;

[iii] Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar - me qëllim të nxitjes së ndjenjës së identitetit kulturor dhe si burim i frymëzimit dhe inovimit.

Strategjia ndërtohet mbi qëllimet (objektivat) konkrete. Objektivat e Strategjisë burojnë nga synimet më lartë dhe mbi bazën e analizës së përvojave të kaluara, gjendjes aktuale në domenin ligjor, infrastrukturor dhe programor, si dhe të çështjeve në fushën e trashëgimisë kulturore që bëhen subjekt trajtimi në dhjetëvjetëshin vijues në Kosovë. Objektivi i parë korrespondon me synimin e parë; objektivat 2 dhe 3 burojnë nga synimi i dytë, ndërsa objektivat 4 dhe 5 nga synimi i tretë. Objektivat janë përkufizuar si më poshtë:

1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale;
2. Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, drejt zhvillimit të qëndrueshëm;
3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore;
4. Promovimi i trashëgimisë kulturore;
5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Objektivat dhe veprimet specifike do të identifikohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore në përputhje me kompetencat e tyre për planifikim dhe veprim strategjik sektorial, si pjesë e procesit të reformës institucionale dhe në funksion të zbatimit të kësaj Strategjie. Prandaj, ky dokument duhet të kuptohet si politikë programore dinamike, e

hapur ndaj kontributeve sektoriale dhe multidisiplinare në fushën e trashëgimisë kulturore.

Në këtë vazhdë, Strategjia përcakton qasjet dhe veprimet orientuese për funksionim efektiv të sektorit të trashëgimisë kulturore në periudhën dhjetëvjeçare 2015-2025.

1. Në fushën e avancimit të kornizës ligjore dhe institucionale, prioritet mbetet investimi në institucionet e trashëgimisë kulturore dhe në sistemin e mbrojtjes në përgjithësi. Paralelisht, avancimi i vazhdueshëm i legjislacionit për trashëgimi kulturore do të përfshijë përveç ligjbërjes edhe masat që garantojnë harmonizimin me ligjet tjera të Kosovës, si dhe me legjislacionin e BE-së. Në funksion të zbatimit të ligjit, Strategjia përcaktohet për veprimtari të integruar të mbrojtjes në sektorët vital si inventarizimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore, menaxhimi dhe monitorimi i gjendjes së trashëgimisë dhe trajtimit të saj, partneriteti dhe bashkëpunimi ndërsektorial.

2. Qasja e integruar me këtë strategji merr përmasa zhvillimore në gjithë territorin e Kosovës duke e promovuar trashëgiminë kulturore si resurs të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Në këtë kuadër, Strategjia përcaktohet për krijim të platformave të asociimit dhe të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe multisektorial për ruajtjen dhe menaxhimin efektiv të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen e saj në agjendën e Qeverisë së Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm.

3. Objektiv i veçantë dhe sfidues në këtë qasje bëhet përfshirja e trashëgimisë kulturore në plane dhe programe zhvillimore komunale dhe kombëtare. Metodologjia dhe praktikrat e mira të konzervimit të integruar të cilat promovojnë konkurrencë të lirë dhe të shëndoshë, si dhe nxitjen e kreativitetit dhe të inovacionit, do të vehen në shërbim të komunave të Kosovës nëpërmjet avancimit dhe zbatimit konsekuent të dokumentit strategjik të MKRS-së për konzervimin e integruar (2010) dhe në harmoni me udhëzimet dhe praktikrat ndërkombëtare. Gjithashtu, vlerësimi i ndikimit në trashëgiminë kulturore si pjesë e mekanizimit për vlerësim të ndikimit në mjedis do të fuqizohet si masë që siguron ruajtjen e autenticitetit dhe meaxhimin adekuat të resurseve dhe pronave kulturore.

4. Komunikimi dhe promovimi gjithëpërfshirës i trashëgimisë kulturore dhe i arritjeve në fushën e zhvillimit kulturor me këtë Strategji bëhet hallkë vitale e procesit të mbrojtjes dhe njehërit e mëvetësishme, e cila garanton promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Strategjia në këtë kuadër shtron si këkresë studimin e plotë dhe sistematik të trashëgimisë kulturore, si dhe interpretimin objektiv për t'u plasuar në botime dhe medime virtuale. Në funksion të zbatimit të këtij qëllimi, investimet do të orientohen në përmirësimin e turizmit kulturor dhe të infrastrukturës përcjellëse për interpretim dhe prezantim, si dhe promovim të diversitetit kulturor dhe simbolikës reprezentative të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës.

5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive, në këtë kuadër, do të përkrahet me qëllim të zhvillimit pozitiv të debatit bashkëkohor në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Së këndejmi, do të përkrahet ndërtimi sistematik i kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore, të cilët përbëjnë burimin formal të komunikimit dhe të veprimit pjesëmarrës me publikun e gjerë. Përtej këtij angazhimi, Strategjia thërret për përmirësim të “qasjes për të gjithë” në trashëgiminë kulturore si e drejtë e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe si kontribut i të gjitha palëve për sigurim të qasjes së papenguar, që garanton

përmirësimin e imazhit Kosovës në sytë e popullatës kosovare dhe të vendeve tjera në botë.

Zbatimi i kësaj Strategjie bazohet në tre hapat fundamentalë si në vijim:

- Plani Orientues (Indikativ) i Veprimit dhe politikat komplementare – Plani Orientues i Veprimit në formatin final të tij do të konkretizojë për secilin objektiv strategjik masat dhe veprimet orientuese, trupat koordinues dhe subjektet e definuara si institucione ose/dhe grupe ndërinstitucionale/multisektoriale për zbatimin e tyre, afatet kohore dhe burimet materiale të nevojshme për zbatim, si dhe indikatorët e monitorimit të zbatimit. Politikat komplementare do të vendosen kundrejt objektivave të kësaj Strategjie dhe do të kualifikohen si:
 - i) të zbatueshme brenda afatit trevjeçar, me ç’rast merr si orientim Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2018 dhe vlerësimin e kornizave buxhetore sektoriale;
 - ii) të zbatueshme brenda afatit dhjetëvjeçar të kësaj Strategjie, që do të definohen më tej nëpërmjet strategjive sektoriale dhe planeve konsekuente të veprimit;
 - iii) me zbatueshmëri që shkon përtej afatit të kësaj Strategjie, e që përmbledh veprime të proceseve të vazhdueshme të cilat garantojnë integrimin e trashëgimisë kulturore në agjendat e zhvillimit të qëndrueshëm .
- Financimi i aktiviteteve – që do të definohet në bazë të vlerësimit të përafërt të burimeve financiare në dispozicion (buxheti i Kosovës, i cili mbetet burimi kryesor i financimit në fushën e trashëgimisë kulturore; fondet e buxhetit të qeverisjes komunale; fondet e IPA-s, donacionet, incentivat, të hyrat vetanake të institucioneve, dhe të tjera) dhe në një analizë financiare dhe të planeve të veprimit, që do të konkretizohen duke marrë për bazë:
 - i) buxhetet e alokuara për veprimet/aktivitetet që janë pjesë e proceseve aktuale;
 - ii) buxhetet e nevojshme dhe afatet për sigurimin e tyre për veprimet/aktivitetet e reja të nevojshme për zbatimin efektiv të objektivave të Strategjisë.
- Mekanizmi për Monitorim të Zbatimit të Strategjisë – Strategjia ordonon krijimin e një Komiteti Monitorues për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturor (KMZ-SKTK) 2015-2025, që për qëllim ka monitorimin e progresit dhe kontrollin e veprimeve që çojnë në zbatimin e objektivave strategjike, si dhe sistemin e komunikimit dhe të raportimit në lidhje me progresin e zbatueshmërisë.

2. HYRJE

Trashëgimia kulturore është definuar si një ndër sektorët prioritarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në Programin e Qeverisë të Republikës së Kosovës 2015-2018 dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2018. Këto dokumente dhe të tjera respektive¹ përbëjnë bazën institucionale për hartimin e kësaj Strategjie Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2015-2025; bazën ligjore e përbëjnë ligjet në fuqi, respektivisht: Ligji për Trashëgimi Kulturore, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligji për Hoçën e Madhe, Ligji për Fshatin Zym; ligjet tjera (Ligji për Planifikimin Hapësinor, Ligji për Arkivat, Muzetë, etj.), aktet ligjore dhe nënligjore, përfshirë provizionet e bashkëpunimit evropian dhe konventat ndërkombëtare të cilat i ratifikon Republika e Kosovës.

Hartimi i kësaj Strategjie afatgjatë shënon një hap të rëndësishëm në konsolidimin e orientimeve, politikave dhe veprimeve strategjike në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe të dokumenteve strategjike dhe programore të hartuara nga MKRS deri më sot. Si e tillë, kjo Strategji synon vendosjen e kornizave afatgjata të vizionimit dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimet e qëndrueshmërisë.

Në kuptimin programor, Strategjia orientohet kah objektivat evropiane për bashkëpunim kulturor të shprehur në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA), qasja gjithëpërfshirëse në fushën e trashëgimisë kulturore e shprehur në praktikat dhe planet e BE-së për kulturë, si dhe bashkëpunimi rajonal, në suaza të Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 për Punësim dhe Prosperitet në Perspektivën Evropiane (SEE 2020).

Korniza e veprimit të kësaj Strategjie mbështetet në parimin bashkëkohor të konceptimit të trashëgimisë kulturore si nocion i hapur dhe dinamik me qëllim të adaptimit ndaj arritjeve dhe sfidave gjithnjë të ndryshueshme në kontekstin zhvillimor global.² Prandaj, ky dokument duhet të kuptohet si politikë programore dinamike, e hapur ndaj kreativitetit dhe diversitetit të kontributeve sektoriale dhe multidisiplinare në fushën e trashëgimisë kulturore. Në këtë vazhdë, objektivat specifike do të identifikohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore në përputhje me kompetencat e tyre për planifikim dhe veprim strategjik sektorial, si pjesë e procesit të reformës institucionale dhe në funksion të zbatimit të kësaj Strategjie.

¹ Përveç Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2018, bazën institucionale për hartimin e Strategjisë e krijojnë edhe: Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme, Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, Strategjia e Kosovës për Konservimin e Integruar, Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2006-2008, dhe dokumentet tjera të politikave të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

² Vizioni i ish Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s, Koichiro Matsuura në adresimin e tij me rastin e prezantimit të arritjeve të Vitit të Kombeve të Bashkuara për Trashëgiminë Kulturore në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në sesionin e tij të 58-të (DG/2003/150): "Ruajtja e Trashëgimisë botërore duhet të nënkuptojë kontributin në mbrojtje të diversitetit kulturor në të gjitha format e saj. Trashëgimia Kulturore është një nocion i hapur që evokon natyrën universale të kreativitetit njerëzor. Ajo përfshin jo vetëm tempuj madhështorë, por edhe kulturën e gjallë." Shih:

http://www.un.org/esa/socdev/unpfii/documents/indigenousanday2008_UNESCO_en.pdf , dhe <http://whc.unesco.org/en/activities/488>

3. METODOLOGJIA

Gjatë hartimit të Strategjisë janë shqyrtuar gjerësisht përvojat e kaluara dhe gjendja e trashëgimisë kulturore në Kosovë, si dhe çështjet që kërkojnë rishikim dhe orientim të ri në periudhën 2015-2025. Çështjet dhe përvojat janë identifikuar në formë të analizës së të dhënave nga dokumentet relevante të rëndësisë kombëtare për Republikën e Kosovës³, si dhe në bazë të përvojës institucionale në ballafaqimin ditor me problematikat e fushës së trashëgimisë kulturore. Faktorët ndikues dhe orientimet e synuara me këtë Strategji janë identifikuar gjatë një procesi pune dhe konsultimesh të grupit punues, nëpërmjet aplikimit të modeleve të afirmuara për analizë të situatave (përfshirë analizën SWOT) dhe për arritje të rezultateve të matshme dhe të zbatueshme (parimeve SMART). Prosesi i punës së grupit punues është zhvilluar në formë të takimeve gjithëditore dhe konsultimeve të vazhdueshme. Gjithashtu, janë mbajtur pesë takime konsultative për hartim draftit të këtij dokumenti.

Disa çështje të identifikuara në dokumentet e mëparshme strategjike dhe tematike të hartuara nga MKRS vazhdojnë të mbajnë rëndësinë; prandaj janë reflektuar edhe në këtë Strategji në formë të rishikuar ashtu që të mundësohet qasja ndërsektoriale.

Institucionet e përfshira në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë janë:

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore;
- Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM;
- Ministria e Integrimit Evropian;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Univeriteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë;
- OJQ-të vendore ‘CHwB’ Prishtinë dhe ‘Ec Ma Ndryshe’ Prizren.

Fazë e rëndësishme e procesit të hartimit të Strategjisë është edhe konsultimi i ekspertëve të fushës dhe palëve të ndryshme të interesit, përfshirja e të cilëve garanton zbatueshmërinë e Strategjisë. Palët që janë konsultuar gjatë përgatitjes së këtij dokumenti janë ekspertë të fushës nga radhët e institucioneve të kulturës, Komunitat e Kosovës, Ministrinë, Agjencionet, komuniteti akademik, shoqëria civile.

³ Dokumentet si: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, dokumentet strategjike të MKRS-së të periudhës kohore midis vitit 2001 dhe 2012, dokumentet tematike të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore, raportet e mekanizmave dhe të organizatave ndërkombëtare, komunave, shoqërisë civile, akademisë, etj.

4. SFONDI

Trashëgimia kulturore e Kosovës është shprehje dhe krijimtari e realiteteve jetësore të zhvilluara në harkun kohor mbi tetë mijë vjet, që nga parahistoria në vijim deri më sot. Kjo pasuri e trashëguar me vlera unike artistike, estetike, historike dhe karakteristika tradicionale, ilustron diversitetin e pasur të trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, si dhe me peizazhin e pasur kulturor.

Si në shumë vende të Evropës Juglindore, sistemi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë nuk është në nivel të kërkesave dhe trendeve bashkëkohore. Kjo mospërputhje shfaqet si pasojë e një historie mbi gjysmëshekullore të instrumentalizimit politik dhe trajtimit subjektiv të saj nga ana e ish pushtetit monist, që përfundoi me shkatërrimin e qindra ndërtesave dhe tërësive kulturore historike në luftën e fundit në Kosovë të viteve 1998/99. Megjithë përpjekjet për përmirësim të gjendjes gjatë periudhës së tranzicionit, sektori i trashëgimisë kulturore mbetet mjaft kompleks dhe i brishtë kundrejt zhvillimeve të reja të përgjithshme. Krahas konsolidimit të institucioneve demokratike, sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës është përmirësuar gradualisht dhe sot zë vend të rëndësishëm në politikat shtetërore.

Megjithë sfidat e shumta, të trashëguara dhe aktuale, MKRS në vazhdimësi ka bërë përpjekje për avancimin e proceseve në fushën e trashëgimisë kulturore, duke e kthyer atë në prioritet qeveritar.

Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore vjen si rezultat i këtij orientimi dhe i nevojës për adresim strukturor të sfidave aktuale dhe të ardhshme, në përputhje me orientimin e Kosovës për bashkëpunim kulturor të hapur dhe intenziv me BE-në në kuadër të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim (MSA), si dhe përcaktimin e saj për aplikim dhe anëtarësim në UNESCO.⁴ Në këtë kuadër, Strategjia adreson tri aspekte themelore që në mënyrë të drejtpërdrejtë synojnë hapjen e perspektivën për promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës, si dhe rritjen e dukshmërisë së potencialit të saj si vlera kombëtare dhe universale.

[i] Në kontekstin e *reformës institucionale dhe ligjore* Strategjia merr rolin e udhërrëfyesit për avancim të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe të sistemit të mbrojtjes, nëpërmjet koordinimit ndër-institucional dhe në përputhje me orientimin e Kosovës kundrejt Prioriteteve të Partneritetit European dhe anëtarësim në UNESCO.

Kosova është e përcaktuar në rrugën e saj drejt integritimit evropian. Pjesë e rëndësishme e këtij angazhimi vazhdon të jetë avancimi i kornizës ligjore dhe

⁴ MSA, Neni 108: Bashkëpunimi kulturor, përcakton ... që të:

“... fuqizohet kapaciteti i veprimeve kulturore dhe që të rritet mirëkuptimi i ndërsjellë ndërmjet individëve, minoriteteve dhe njerëzve. Gjithashtu, bashkëpunimi do të përkrahë reformën institucionale me qëllim të promovimit të diversitetit kulturor në Kosovë, përfshirë themelet e parimeve të mishëruara në Konventën e UNESCOs për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore, miratuar në Paris në Tetor 2005”

institucionale në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, dhe në harmoni me standardet e BE-së dhe kritereve të UNESCO-s. Në këtë drejtim, Strategjia synon strukturimin sistematik të trashëgimisë kulturore në kuadrin ligjor të Kosovës dhe rrjetëzimin efektiv të institucioneve të trashëgimisë kulturore.

[ii] Qasja e integruar⁵ të cilën e promovon kjo Strategji përbën boshtin e sistemit të ruajtjes, mbrojtjes, përdorimit dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës sipas parimeve ndërkombëtare dhe trendeve të zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

Përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore është përgjegjësi e të gjithëve dhe faktor i rëndësishëm në zhvillim të qëndrueshëm urban, shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit. Standard në fushën e trashëgimisë është pikërisht natyra multidiciplinare e saj. Aktualisht trashëgimia kulturore e Kosovës nuk është e përfshirë në planet zhvillimore në nivelin e dëshiruar. Në këtë kuadër, sfidë e veçantë për Kosovën mbetet koordinimi ndërinstitutional dhe gjithëpërfshirja në proceset e planifikimit dhe të menaxhimit të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe kulturore, me fokus në planet zhvillimore hapësinore dhe urbane. Në këtë drejtim, Strategjia synon strukturimin sistematik të trashëgimisë kulturore nëpërmjet qasjes së integruar në planifikim dhe menaxhim të zhvillimeve në vend.

[iii] Si përgjigje nevojës për edukim, promovim dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm qytetar, Strategjia e kthen fokusin te roli i pakontestueshëm që ka trashëgimia kulturore në nxitjen e ndjenjës së identitetit kulturor dhe të përkatësisë, dhe si burim i frymëzimit dhe inovimit për gjeneratat e reja.

Trashëgimia kulturore e Kosovës është pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e mjedisit tonë jetësor, si dhe konsiderohet pasuri e mbarë brezave të shoqërisë kosovare. Humbja e saj është vlerë e pakthyeshme në dëm të identitetit dhe diversitetit kulturor të vendit. Si pjesë e rëndësishme e procesit të mbrojtjes, njëherit sfidë e veçantë për Kosovën, mbetet edukimi dhe ndërgjegjësimi qytetar, si dhe promovimi dhe rritja e dukshmërisë së potencialit të vlerave të trashëgimisë kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Thëks të veçantë në këtë proces do të ketë mbrojtja efektive e trashëgimisë shpirtërore.

Procesi i zbatimit të kësaj Strategjie do të zhvillohet në periudhë afatgjate, nëpërmjet Planifikimit Strategjik të MKRS, planeve të veprimit dhe programeve të hollësishme për trashëgimi kulturore. Në proces do të përfshihen aktorë të ndryshëm nga nivele relevante ministrore, institucione qendrore dhe lokale, si dhe ato ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të sinergjisë së dëshiruar në funksion të përmbushjes së prioritetëve qeveritare.

⁵ Qasja e integruar për shfrytëzim të resurseve në dispozicion me qëllim të përkrahjes, përmirësimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore të bazuar në qasjen e integruar gjithëpërfshirëse është prioritet në agjendën evropiane. Shih Draft raportin e Parlamentit Evropian (mars 2015). “Drejt qasjes së integruar në trashëgiminë kulturore për Evropën” (2014/2149(INI)). Në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+COMPARL+PE-546.783+01+DOC+PDF+V0//EN&language=EN>

5. VIZIONI, SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

VIZIONI

Trashëgimia kulturore në dhjetë vitet e ardhshme do të jetë shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Në funksion të kësaj, Qeveria e Kosovës do të punojë në avansimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes, në bashkëpunimin efektiv dhe rritjen e pjesëmarrjes në proceset e planifikimit dhe të menaxhimit të zhvillimeve, si dhe në promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës.

SYNIMET	OBJEKTIVAT
[i] Në kontekstin e reformës institucionale dhe ligjore Strategjia merr rolin e udhëzuesit për avancim të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe të sistemit të mbrojtjes, nëpërmjet koordinimit ndër-institucional dhe në përputhje me orientimin e Qeverisë së Kosovës kundrejt Prioriteteve të Partneritetit European dhe anëtarësimit në UNESCO.	1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale Investimi në institucionet e trashëgimisë kulturore dhe në sistemin e mbrojtjes ligjore mbetet prioritet edhe gjatë periudhës së kësaj Strategjie
[ii] Qasja e integruar të cilën e promovon kjo Strategji përbën boshtin e sistemit të ruajtjes, mbrojtjes, përdorimit dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës sipas parimeve ndërkombëtare dhe trendeve të zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor.	2. Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm Trashëgimia kulturore bëhet resurs i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor nëpërmjet bashkëpunimit ndër-institucional dhe multisektorial 3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore Konservimi i integruar i bazuar në plane të zhvillimit dhe menaxhimit dhe në projekte të qëndrueshme e zëvendëson qasjen e deritanishme të bazuar në veprime konservuese-restauruese
[iii] Si përgjigje nevojës për edukim, promovim dhe ndërjegjësim të vazhdueshëm qytetar, Strategjia e kthen fokusin te roli i pakontestueshëm që ka trashëgimia kulturore në nxitjen e ndjenjës së identitetit kulturor dhe të përkatësisë, dhe si burim i frymëzimit dhe inovimit për gjeneratat e reja.	4. Promovimi i trashëgimisë kulturore Komunikimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore do të nxjerrë në pah vlerat reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës 5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore Zhvillimi i debatit bashkëkohor në fushën e trashëgimisë kulturore do të kontribuojë në përmirësimin e imazhit të Kosovës

OBJEKTIVI 1: AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
 INVESTIMI NË INSTITUCIONET E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NË
 SISTEMIN E MBROJTJES LIGJORE MBETET PRIORITET EDHE GJATË
 PERIUdhËS SË KËSAJ STRATEGJIE

1.1. Avancimi, harmonizimi dhe zbatimi i legjislacionit

- 1.1.1. Kompletimi i legjislacionit, harmonizimi i Ligjit dhe akteve ligjore të trashëgimisë kulturore me ligjet tjera të Kosovës;
- 1.1.2. Përafrimi i vazhdueshëm i legjislacionit për trashëgiminë kulturore me Legjislacionin e BE-së;
- 1.1.3. Zbatimi efektiv i legjislacionit dhe politikave për trashëgiminë kulturore;
- 1.1.4. Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare.

1.2. Zhvillimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore

- 1.2.1. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknike të institucioneve të trashëgimisë kulturore;
- 1.2.2. Reformimi dhe rrjetëzimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore;
- 1.2.3. Transparenca dhe llogaridhënia;
- 1.2.4. Partneriteti me institucionet homologe në rajon dhe më gjerë;

1.3. Inventarizimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore

- 1.3.1. Mirëmbajtja dhe avansimi i bazës digjitale të të dhënave;
- 1.3.2. Plotësimi i listës me kategorinë e trashëgimisë shpirtërore dhe peisazheve kulturore;
- 1.3.3. Mirëmbajtja e vazhdueshme e Listës së Përkohshme dhe krijimi i Regjistrit Nacional;
- 1.3.4. Integrimi i lokalitetetve të trashëgimisë së ndërtuar në sistemet e të dhënave kombëtare.

Nën këtë seksion janë të përfshira tri veprimet orientuese dhe 13 masa që synojnë avancimin përmbajtësor dhe afatgjatë të sistemit ligjor dhe institucional të trashëgimisë kulturore në Kosovë; pesë prej tyre korrespondojnë me synimet e Programit të Qeverisë së Kosovës (2015-2018). Afatet dhe buxhetet orientuese të definuara me këtë Strategji do të shërbejnë për hartimin e politikave shtesë, përfshirë koncept dokumentet, dhe planet e veprimit, që do të hartohen nga subjektet e definuara me këtë Strategji si institucione bartëse ose/dhe grupe ndërinstitutionale/multisektoriale, në përputhje me kornizën e Planit Orientues të Veprimit të kësaj Strategjie. Ky objektivi do të zbatohet me mbështetjen e Qeverisë së Kosovës, dhe nëpërmjet koordinimit ndërministror (përfshirë atë ndërinstitutional të MKRS-së me KKTK, agjencionet kombëtare, dhe institucionet vartëse të MKRS).

Masat e përfshira në Veprimin orientues 1.1. adresojnë kornizën ligjore: kompletimin dhe harmonizimin sistematik të legjislacionit të trashëgimisë kulturore me ligjet tjera të Kosovës dhe me ato të BE-së, zbatimin efektiv të politikave të trashëgimisë kulturore, si dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, me fokus në UNESCO. Kthimi i thesarit arkeologjik dhe etnologjik të Kosovës dhe i dokumentacionit arkivor të trashëgimisë kulturore nga Serbia mbetet adresim i vazhdueshëm në platformat ndërkombëtare. Masat e përvetësuara nën këtë Orientim janë kryesisht veprime të cilat janë pjesë e procesit të vazhdueshëm të punës së MKRS-së në fuqizimin e kornizës ligjore dhe institucionale. Disa veprime të reja promovohen këtu për herë të parë me qëllim të zbatimit efektiv dhe përmbajtësor të këtij veprimit orientues, si: hartimi i komentarit të provizioneve ligjore që e rregullojnë trashëgiminë kulturore në legjislacionin kosovar, valorizimi konform kriterëve për Trashëgiminë Kulturore Botërore, vendosja e mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit, menaxhimi i zbatimit, përfshirë përmbushjen e rekomandimeve të Raportit të Progresit 2014 në lidhje me zbatimin efektiv të politikave dhe legjislacionit në fuqi.⁶

Veprimi orientues 1.2. adreson zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve të trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknike është masë që vazhdon të mbetet pjesë e punës së MKRS, si parakusht për zbatim të reformës institucionale dhe të praktikave të qeverisjes së mirë (transparenca dhe llogaridhënia). Masat e përfshira këtu adresojnë definimin e statusit të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe themelimin e institucioneve të reja (Muzeut Arkeologjik, Muzeut Etnologjik, dhe Muzeut të Historisë së Natyrës.). Funkcionalizimi i plotë dhe rrjetëzimi i tyre është proces që me këtë Strategji synohet të përmbillet, me ç'rast hapen mundësi për krijim të partneriteteve të qëndrueshme me institucione homologe në rajon dhe më gjerë në fushat specialistike të trashëgimisë kulturore (gërmim, konservim/restaurim, inventarizim, buxhetim, edukim). Zbatimi i këtij veprimi orientues mbështetet edhe në përvojën e MKRS dhe angazhimin e vazhdueshëm në kuadër të bashkëpunimit për rehabilitimin e trashëgimisë rajonale (Procesi i Lubjanës⁷).

Veprimi orientues 1.3. fokusohet në avancimin e sistemit të inventarizimit dhe të digjitalizimit të trashëgimisë kulturore sipas parimeve udhëheqëse të BE-së dhe kriterëve të UNESCO-s, dhe praktikave të mira në rajon dhe botë. Përveç përditësimit dhe publikimit të Listës së Përkohëshme dhe plotësimit në vazhdimësi të Databazës së Trashëgimisë Kulturore (DTK), masat kritike të përfshira në këtë veprim orientues janë: përnjohja/hulumtimi, dokumentimi dhe valorizimi i trashëgimisë shpirtërore dhe peisazheve kulturore, krijimi i modelit të dosjes për mbrojtje të përhershme, vendosja e platformës procedurale për Regjistrin Nacional, si dhe integrimi i të dhënave hartografike dhe numerike në sistemin e të dhënave kombëtare/ rajonale.

⁶ Gjetjet përmbledhëse të Raportit të Progresit 2014 adresojnë çështjet e zbatimit të legjislacionit në fuqi, të artikulara me këtë Strategji si aktivitete nën pikën 1.1.4, si në vijim:

- Zbatimi i Ligjit për Zonën Historike të Prizrenit, duke e fuqizuar mekanizmat e vendosur (Këshilli i TK dhe Task Forca) dhe procesin e punës dhe të bashkëpunimit me komunën e Prizrenit ;
- Zbatimi i Ligjit / instruksioneve administrative për Hoçën e Madhe në bashkëpunim me MMPH;
- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme teknike në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe në funksion të zbatimit të Ligjit për Zonat e Veçanta, në bashkëpunim sistematik me MMPH.

⁷ Shih më shumë në faqen zyrtare të Këshillit të Evropës në:

https://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/see/irppsaaah/ljubljanaprocess_EN.asp

OBJEKTIVI 2: QASJA E INTEGRUAR NË TRASHËGIMINË KULTURORE, DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

TRASHËGIMIA KULTURORE BËHET RESURS I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK, SHOQËROR DHE KULTUROR NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL DHE MULTISEKTORIAL

2.1. Ruajtja dhe menaxhimi efektiv i aseteve të trashëgimisë kulturore si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm

- 2.1.1. Vazhdimi dhe avancimi i programit për intervenime emergjente;
- 2.1.2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e aseteve të trashëgimisë kulturore;
- 2.1.3. Hartimi i planeve të menaxhimit dhe caktimi i njësive menaxhuese për lokalitetet madhore të trashëgimisë kulturore;
- 2.1.4. Përmirësimi i qasjes publike dhe promovimi i përdorimeve të qëndrueshme të aseteve të trashëgimisë kulturore;

2.2. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm⁸

- 2.2.1. Identifikimi dhe mbrojtja ligjore e peisazheve kulturore;⁹
- 2.2.2. Përfshirja e peisazheve kulturore në mekanizmat e planifikimit dhe të menaxhimit të zhvillimeve socio-ekonomike dhe hapësinore;
- 2.2.3. Promovimi i turizmit të qëndrueshëm në zonat dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore.¹⁰

2.3. Krijimi dhe asociimi në platformat e bashkëpunimit

- 2.3.1. Bashkëpunimi multisektorial dhe ndërinstitucional në planifikim dhe menaxhim të qëndrueshëm projekteve zhvillimore / investimeve kapitale ;
- 2.3.2. Bashkëpunimi ndërkomunal në planifikim dhe menaxhim të qëndrueshëm të territoreve dhe itinerareve ndërkomunale të trashëgimisë kulturore ;
- 2.3.3. Bashkëpunimi ndërkufitar në planifikim dhe menaxhim të qëndrueshëm të projekteve që promovojnë diversitetin kulturor dhe identitetin evropian të rajonit.

⁸ Në harmoni me dokumentin e UNESCO-s për përfshirje të trashëgimisë kulturore në Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Prill 2013). Në:

<http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/HeritageENG.pdf>

⁹ Në harmoni me Konventën Evropiane për Peisazhet (2000). Në:

<http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/176.htm>

¹⁰ Në harmoni me Kartën e BE-së për Turizmin Kulturor (2007) Në:

<http://www.alcornocales.org/gestor//images/cets/PDF/01OFFICIALTEXT.pdf>

Definicioni i “turizmit të qëndrueshëm” sipas Konventës Evropiane: “çdo formë e zhvillimit të turizmit, menaxhimit apo aktiviteti që siguron ruajtjen dhe mbrojtjen afatgjatë të burimeve natyrore, kulturore dhe sociale dhe që kontribuon në mënyrë pozitive dhe të barabartë në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien e individëve të cilët jetojnë, punojnë, ose qëndrojnë në zonat e mbrojtura”.

Nën këtë seksion janë të përfshira tri veprimet orientuese dhe 11 masa që synojnë zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet qasjes së integruar; dy prej tyre korrespondojnë me synimet e Programit të Qeverisë së Kosovës (2015-2018) dhe dy me orientimet e Planit të Punës për Kulturë të BE-së (2015-2018). Zbatimi i këtij objektiv varet në masë të madhe nga bashkëpunimi efektiv ndër-institucional dhe multisektorial i shprehur në politikat dhe dokumentet strategjike kombëtare që do të harmonizohen nëpërmjet punës sistematike të grupeve punuese ndërministrorë dhe me kontributin e institucioneve hulumtuese dhe arsimore në Kosovë. Veprimet orientuese të përvetësuara në këtë objektiv marrin parasysh kufizimet buxhetore dhe mundësitë reale për implementim brenda periudhës kohore të kësaj Strategjie.

Masat e përfshira në Veprimin orientues 2.1. janë kryesisht veprime të cilat janë pjesë e procesit të vazhdueshëm të punës së MKRS-së; dy prej tyre kërkojnë koordinim të veprimeve me Qeverinë e Kosovës: themelimi i një Fondi si kusht për avancim të programit të intervenimeve emergjente, si dhe shenjëzimi në të gjitha nivelet si parakusht në përmirësim efektiv të qasjes publike dhe promovim të përdorimeve të qëndrueshme të aseteve të trashëgimisë kulturore. Prioritet buxhetor do të ketë ridefinimi i sistemit të monitorimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të trashëgimisë kulturore, si dhe prioritetizimi dhe hartimi i planeve të menaxhimit. Veprim konkret implementues i bazuar në punën e deritanishme të MKRS është themelimi i parqeve arkeologjike në lokalitetet e Ulpianës dhe të Dresnikut.

Veprimi orientues 2.2. krijon një platformë të bashkëpunimit sistematik me MMPH, MZHE dhe MTI për integrim të trashëgimisë kulturore në agjendën e zhvillimit socio-ekonomik, kulturor dhe hapësinor të Kosovës dhe promovimin e saj si resurs i zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia e definon peisazhin kulturor si subjekt dhe fokus të kësaj platforme për të cilën përcaktohet edhe hartimi i një programi/strategjie të veçantë. Procesi i identifikimit, mbrojtjes ligjore dhe përfshirjes së peisazheve kulturore në mekanizmat e planifikimit dhe të menaxhimit të zhvillimeve socio-ekonomike do të zhvillohet dhe koordinohet nga MKRS në përputhje me kriteret e Konventës Evropiane dhe prioritetet e Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor/urban dhe ekonomi të hapur dhe konkurruese.

Veprimi orientues 2.3. është pjesë e procesit të vazhdueshëm të punës së Qeverisë së Kosovës për promovim të trashëgimisë kulturore dhe të turizmit kulturor në vend dhe jashtë. Masat fokusohen kryesisht në krijimin e mekanizmave për bashkëpunim sistematik dhe tematik në nivel kombëtar: ndërmintor, ndërkomunal dhe ndër-institucional, si dhe në nivel rajonal, me fokus në bashkëpunimin ndërkufitar.

OBJEKTIVI 3: PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANET ZHVILLIMORE

KONSERVIMI I INTEGRUAR I BAZUAR NË PLANE TË ZHVILLIMIT DHE MENAXHIMIT DHE NË PROJEKTE TË QËNDRUESHME E ZËVENDËSON QASJEN E DERITANISHME TË BAZUAR NË VEPRIME KONSERVUESE-RESTAURUESE

3.1. Fuqizimi i konservimit të integruar si koncept fundamental për zhvillim të qëndrueshëm¹¹

- 3.1.1. Përditësimi i dokumentit strategjik të MKRS mbi Konservimin e Integruar;
- 3.1.2. Zhvillimi i politikave dhe instrumenteve për planifikimin dhe menaxhimin e integruar dhe efektiv të trashëgimisë kulturore.
- 3.1.3. Krijimi i një kornize eksperimentimi për planifikim territorial dinamik dhe sistematik¹²

3.2. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në politikat dhe dokumentet kombëtare të planifikimit hapësinor

- 3.2.1. Përditësimi i provizioneve të trashëgimisë kulturore në dokumentin e Planit Hapësinor të Kosovës dhe përfshirja e saj në Hartën Zonale të Kosovës;
- 3.2.2. Identifikimi/fuqizimi i masave administrative, financiare dhe edukative të konservimit të integruar, dhe përfshirja e tyre në politikat kombëtare;
- 3.2.3. Avancimi /koordinimi i masave legjislativë për parandalim të zhvillimit të pakontrolluar urban dhe rural;¹³
- 3.2.4. Fuqizimi i vlerësimit të ndikimit në trashëgiminë kulturore si pjesë e mekanizmit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-së).

3.3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit komunal

- 3.3.1. Definimi i zonave/qendrave historike urbane dhe rurale dhe integrimi i tyre në proceset e planifikimit zhvillimor komunal;
- 3.3.2. Përvetësimi i qasjes së integruar ndaj konservimit dhe zhvillimit urban dhe reflektimi i saj në hartën zonale të komunave;
- 3.3.3. Zhvillimi i pilot projekteve të bazuara në qasjen e integruar konform parimeve dhe praktikave bashkëkohore për konservim, restaurim dhe ripërdorim adaptiv;
- 3.3.4. Përvetësimi i qasjes së bazuar në Peisazhin Historik Urban për planifikim dhe menaxhim ndërkomunal të zonave/teritoreve më të gjera të trashëgimisë kulturore, sipas rekomandimeve të UNESCO-s (2011)¹⁴

¹¹ Konform parimeve të definuara në dokumentet doktrinare ndërkombëtare (UNESCO, ICOMOS, KE).

¹² Bazuar në dokumentin e Komisionit Evropian, ESDP – Perspektiva e Zhvillimit Hapësinor Evropian Drejt zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të Bashkimit Evropian (1999)

¹³ Në funksion të zbatimit të Ligjit nr. 04/l-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

¹⁴ Rekomandimi i UNESCO-s për Peisazhin Historik Urban (Historic Urban Landscape-HUL); Shih Rezolutën (2012) ff. 50-55. Në: <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002150/215084e.pdf#page=52>

Nën këtë seksion janë të përfshira tri veprimet orientuese dhe 11 masa që synojnë zbatimin e parimeve të konservimit të integruar. Zbatimi i këtij objekti kërkon vendosjen e një platforme të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe të strukturuar të MKRS me MMPH, MAPL dhe veçanërisht me komunat e Kosovës, si dhe thellimin e partneritetit dhe planifikimit pjesëmarrës me qytetarët, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

Veprimi orientues 3.1. përfshin masa të cilat synojnë vendosjen e parimeve të konservimit të integruar dhe integrimin e tyre përmbajtësor dhe afatgjatë në proceset e planifikimit, zhvillimit dhe të menaxhimit të zonave të mbrojtura. Prioritet do të ketë përditësimi i dokumentit strategjik të MKRS mbi Konservimin e Integruar për t'iu përgjigjur objektivave të kësaj Strategjie. Pjesë e pashmangshme në këtë përpjekje është zhvillimi i politikave dhe instrumenteve për menaxhimin e integruar dhe efektiv të trashëgimisë kulturore duke pasur parasysh rekomandimet e definuara në dokumentet doktrinare ndërkombëtare, si dhe kufizimet buxhetore dhe mundësitë reale zhvillimore në Kosovë.

Veprimi orientues 3.2. synon zbatimin efektiv të provizioneve legjislativë në fushën e planifikimit hapësinor dhe trashëgimisë kulturore që do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit sistematik të MKRS me MMPH, MAPL, komunat e Kosovës dhe institucionet e tjera përgjegjëse në këto fusha. Prioritet programor do të ketë përfshirja e trashëgimisë kulturore në politikat dhe dokumentet kombëtare të planifikimit hapësinor (Plani Hapësinor i Kosovës dhe Harta Zonale e Kosovës, dhe politikat tjera). Strategjia në këtë seksion thërret për fuqizimin e vlerësimit të ndikimit në trashëgiminë kulturore si pjesë e mekanizimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-së) me qëllim që të sigurohet mbrojtja nga zhvillimet joadekuate të zonave të mbrojtura urbane dhe rurale. Në këtë pikë, do të operacionalizohet veprimi i përbashkët i MKRS, MMPH, MAPL, komunave dhe inspektorateve të nivelit qendror dhe lokal, në funksion të zbatimit të Ligjit për Ndërtimet pa Leje.¹⁵

Përfshirja e trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit komunal përbën objektin dhe njëherit një sfidë të veçantë për komunat e Kosovës. Veprimi orientues 3.3. adreson kryesisht veprime të cilat janë pjesë e proceseve tanimë të etabluara për mbrojtjen e zonave/qendrave historike në qytete dhe fshatëra, por që duhet të avancohen në kuptimin e mbulueshmërisë territoriale, si dhe akomodimit të metodologjive dhe praktikave të mira të konservimit të integruar që promovojnë nxitjen e kreativitetit dhe të inovacionit, të bazuar në konkurrencën e shëndoshë. Prioritet buxhetor do të ketë definimi i zonave /qendrave historike urbane dhe rurale dhe reflektimi i tyre në planet zhvillimore komunale dhe hartat zonale të komunave. MKRS në bashkëpunim me komunat e Kosovës do të stimulojë zhvillimin e pilot projekteve që promovojnë qasjen e integruar konform parimeve dhe praktikave bashkëkohore për konservim, restaurim dhe ripërdorim adaptiv të trashëgimisë së ndërtuar. Prioritet programor do të ketë identifikimi i pilot projekteve që promovojnë qasjen e bazuar në Peisazhin Historik Urban për planifikim dhe menaxhim ndërkomunal të zonave/territoreve më të gjera të trashëgimisë kulturore, sipas rekomandimeve të UNESCO-s.

¹⁵ Gjithashtu identifikohet si rekomandim në Raportin e Progresit për Kosovën 2014.

OBJEKTIVI 4: PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE

KOMUNIKIMI DHE PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE DO TË NXJERRË NË PAH VLERAT REALE SOCIO-KULTURORE DHE EKONOMIKE TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË KOSOVËS

4.1. Studimi dhe interpretimi i trashëgimisë kulturore

- 4.1.1. Studimi dhe interpretimi objektiv i vlerave socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës;
- 4.1.2. Rritja e numrit të botimeve, guidave, medimeve virtuale, etj. dhe shpërndarja sistematike në vend dhe në rrafshin ndërkombëtar;
- 4.1.3. Rritja e përdorimit të mediave digjitale dhe rrjeteve online për promovim të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

4.2. Zhvillimi i turizmit kulturor në bazë të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm¹⁶

- 4.2.1. Përvetësimi i qasjeve strategjike për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm;¹⁷
- 4.2.2. Përmirësimi i infrastrukturës turistike, standardizimi dhe shpërndarja hapësinore në linja/pika strategjike në gjithë territorin e Kosovës;
- 4.2.3. Krijimi i simbolikës reprezentative për asetet dhe lokalitetet madhore të trashëgimisë kulturore;
- 4.2.4. Promovimi i gastronomisë lokale tradicionale si prodhim turistik;
- 4.2.5. Marketimi dhe brendimi i vlerave sinjifikante kulturore dhe socio-ekonomike të trashëgimisë kulturore dhe promovimi i tyre sipas parimeve globale të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

4.3. Promovimi i diversitetit kulturor, respektimi dhe mbrojtja e trashëgimisë dhe shprehjes kulturore të minoriteteve të Kosovës

- 4.3.1. Diseminimi i Konventës së ratifikuar për Diversitetin Kulturor;¹⁸
- 4.3.2. Respektimi dhe mbrojtja e trashëgimisë dhe shprehjes kulturore të minoriteteve të Kosovës;
- 4.3.3. Promovimi i veprimeve konkrete dhe i respektit dhe besueshmërisë midis komuniteteve si vlera të shtuara.¹⁹

¹⁶ Veprimet orientuese korespondojnë gjithashtu me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018; njëherit janë në harmoni me Kartën e BE-së për Turizmin Kulturor (2007) Në: <http://www.alcornocales.org/gestor/images/cets/PDF/01OFFICIALTEXT.pdf>

¹⁷ Sipas rekomandimit të Kartës së BE-së për Turizmin Kulturor (2007)

¹⁸ Korrespondin me orientimin D1) të Planit të Punës për Kulturë të BE-së (2015-2018): "Konventa e UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore".

¹⁹ Pika 4.3.2 dhe 4.3.3. adresojnë rekomandimet e Raportit të Progresit 2014 të listuara nën pikën 2. Kriteret Politike, Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve, të drejtat kulturore. Në funksion të zbatimit të rekomandimeve, Strategjia artikulon aktivitetet si në vijim:

Nën këtë seksion janë të përfshira tri veprime orientuese dhe 10 masa që synojnë komunikimin dhe promovimin trashëgimisë dhe të diversitetit të shprehjes kulturore në Kosovë, plasimin në kuadër të turizmit kulturor dhe në kushte të zhvillimit të qëndrueshëm. Katër veprime orientuese korrespondojnë me synimet e Programit të Qeverisë së Kosovës (2015-2018), dy prej tyre me rekomandimet e Kartës Evropiane për Turizmin Kulturor dhe dy me orientimet e Planit të Punës për Kulturë të BE-së (2015-2018). Zbatimi i këtij objekti varet në masë të madhe nga partneriteti për planifikim dhe zhvillim të intepretimit, prezantimit dhe komunikimit, marketimit dhe brendimit të trashëgimisë kulturore, në rrafshin publik dhe me sektorin shoqëror dhe privat. Me këtë seksion ordinohe hartimi i dokumenteve strategjike të cilat do të përcaktojnë orientimet specifike dhe mundësitë reale për implementim të kësaj Strategjie.

Masat e përfshira në veprimin orientues 4.1. janë kryesisht veprime të cilat janë pjesë e procesit të vazhdueshëm të punës së MKRS-së dhe që ndërlidhen me studimin, interpretimin dhe botimin e studimeve dhe të materialeve promovuese; masat dhe aktivitetet përcjellëse që ndërlidhen me zhvillimin e turizmit kulturor kërkojnë koordinim të veprimeve me Qeverinë e Kosovës (psh. hapja e faqeve turistike për tërë territorin e Kosovës dhe vendet turistike veç e veç si parakusht për rritjen e përdorimit të mediave digjitale dhe rrjeteve online për promovim të trashëgimisë kulturore të Kosovës).

Veprimi orientues 4.2. krijon platformën për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm konform parimeve dhe praktikave botërore dhe mbështetur në Kartën Evropiane (2007) dhe Udhëzimet Ndërkombëtare për Turizmin e Qëndrueshëm, të promovuar nga UNESCO.²⁰ Prioritet programor do të ketë plasimi i simbolikës reprezentative që do të përdoret për krijim të brendeve dhe marketim të produkteve tradicionale dhe të vlerave sinjifikante të trashëgimisë. Prioritet buxhetor do të ketë përmirësimi i infrastrukturës turistike (shenjëzimi, infoqendrat, lidhja ngjarje-operatorë, etj.) me mbështetjen programore të Qeverisë së Kosovës, standardizimi i pikave të informimit sipas modelit të përzgjedhur në bashkëpunim me MTI dhe shpërndarja hapësinore në linjat/pikat strategjike (aerporte, stacione treni/autobusi, qendra qytetesh) në bashkëpunim me komunat dhe ministritë përkatëse. Definimi i këtij veprimi orientues 4.2. dhe bashkëveprimi me orientimet e objektivave tjera të kësaj Strategjie do të bëhet konform qasjeve strategjike për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm që do të përvetësohen nga institucionet e platformës së partneritetit, e cila promovohet me këtë Strategji.

Veprimi orientues 4.3. synon promovimin e diversitetit kulturor nëpërmjet diseminimit gjithëpërfshirës të Konventës së UNESCO-s për Diversitetin Kulturor. Masa prioritare në këtë drejtim mbeten veprimet që promovojnë bashkëpunim koherent, si dhe respektim dhe mbrojtje të trashëgimisë dhe shprehjes kulturore të minoriteteve të Kosovës.

-
- Mbështetja e integritit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, nëpërmjet punës aktive të Komitetit për Kulturë dhe Informim të MKRS” (gjithashtu, korrespondon/koordinohet me Veprimin 1. të objektivit 4. të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2007-2017.
 - Thellimi i bashkëpunimit me Kishës Ortodokse Serbe duke vazhduar me implementimin e veprimeve konkrete dhe duke ndërtuar besueshmëri dhe respekt të ndërsjellë;

²⁰ Shih: “International Guidelines for Sustainable Tourism” në portalin e UNESCO-s. Udhëzimet mbulojnë turizmin masiv konvencional, ekoturizmin, turizmin kulturor, turizmin detar, rekreimin dhe turizmin sportiv.

Në: http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13970&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html

OBJEKTIVI 5: EDUKIMI, AFTËSIMI DHE PJESËMARRJA AKTIVE NË MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

ZHVILLIMI I DEBATIT BASHKËKOHOR NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE DO TË KONTRIBUOJË NË PËRMIRËSIMIN E IMAZHIT TË KOSOVËS

5.1. Përmirësimi i “qasjes për të gjithë” në trashëgiminë kulturore

- 5.1.1. Promovimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore, me qëllim të fuqizimit të debatit publik dhe ndërgjegjësimit lidhur me objektivat e Strategjisë kombëtare
- 5.1.2. Përmirësimi i qasjes intelektuale, fizike dhe virtuale²¹ në asetet dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore
- 5.1.3. Promovimi i përdorimeve alternative të lokaliteteve të trashëgimisë, me qëllim të fuqizimit të lidhjes midis trashëgimisë kulturore dhe arteve
- 5.1.4. Promovimi i dijeve tradicionale, transferi i kujtesës kolektive dhe rrëfimeve gojore nga brezi i vjetër tek brezi i ri.

5.2. Përmirësimi i kapaciteteve profesionale te punonjësve të trashëgimisë kulturore

- 5.2.1. Specializimi profesional dhe licencimi i palëve të angazhuara në veprimtari konservuese-restauruese.
- 5.2.2. Programet trajnuese për ciceronë dhe kuratorë muzeal, menaxherë, laborantë dhe profesionistë të tjerë të fushës;
- 5.2.3. Zhvillimi i moduleve të edukimit formal dhe joformal, organizimi i hulumtimeve shkencore, debateve dhe konferencave në fushën e trashëgimisë kulturore.
- 5.2.4. Trajnimi në përdorimin e teknologjive dhe aparaturës teknike për dokumentim dhe trajtim bashkëkohor të trashëgimisë kulturore

5.3. Edukimi i gjeneratave te reja mbi trashëgiminë kulturore

- 5.3.1. Përfshirja sistematike e trashëgimisë kulturore në kurikulat e sistemit të edukimit
- 5.3.2. Studimi, njohja, arkivimi, dokumentimi i praktikave dhe teknikave të artit tradicional²²
- 5.3.3. Inkurajimi i ideve kreative, filantropisë, bamirësisë

Nën këtë seksion janë të përfshira tri veprime orientuese dhe 11 masa që synojnë ngritjen e nivelit të edukimit, aftësimin dhe pjesëmarrjen aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me qëllim të ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të publikut të brendshëm dhe të jashtëm si faktor i rëndësishëm në zhvillimin pozitiv të imazhit kulturor të Kosovës.

²¹ Korrespondon pjesërisht me orientimin A2) të Planit të Punës për Kulturë të BE-së (2015-2018).”Promovimi i qasjes në kulturë nëpërmjet mjeteve digjitale: politikat dhe strategjitë për zhvillim të audiencës.”

²² Korrespondon pjesërisht me orientimin B2) të Planit të Punës për Kulturë të BE-së (2015-2018): “Aftësitë, trajnimi, transferimi i njohurive: trashëgimia tradicionale dhe profesionet e reja në fushën e trashëgimisë.”

Masat e përfshira në veprimin orientues 5.1. promovojnë qasjen e papenguar në trashëgiminë kulturore si segment i rëndësishëm i të drejtave të njeriut dhe si kusht i patjetërsueshëm për edukim kulturor, aftësim profesional dhe avancim të debatit bashkëkohor në çështjet e fushës së trashëgimisë kulturore.²³ Përmirësimi i qasjes për të gjithë si dhe promovimi i dijeve përcaktohet në këtë Strategji mbështetur në Deklaratën e UNESCO-s për Diversitetin Kulturor²⁴ dhe merr gjithashtu parasysh orientimet e Planit të Punës për Kulturë të BE-së (2015-2018). Prioritet programor do të ketë promovimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2015-2025 me qëllim të ndërgjegjësimit lidhur me objektivat e Strategjisë. Veprim me prioritet buxhetor në këtë pikë do të jetë zbatimi i pilot projekteve, të cilat, veç tjerash, mundësojnë promovimin e Strategjisë dhe diseminimin gjithëpërfshirës të objektivave të saj, dhe të cilat mund të shërbejnë si shembuj për transferin e përvojës së fituar në aktivitetet e tjera të Strategjisë.

Veprimi orientues 5.2. synon zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme të edukimit dhe të aftësimit formal dhe joformal në sektorin e ruajtjes, trajtimit, përdorimit adaptiv dhe të promovimit të trashëgimisë kulturore bazuar në parimet e qëndrueshmërisë. Prioritet ligjor vazhdon të mbetet specializimi profesional dhe licencimi i palëve të angazhuara në veprimtari konservuese-restauruese, si kusht themelor për zhvillim të kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore. Ky veprim orientues synon gjithashtu konsolidimin kualitativ dhe përmbajtësor të veprimtarive dhe programeve trajnuese të ofruara nga institucionet publike, programet ndërkombëtare dhe shoqëria civile (psh. programe për ciceronë, kuratorë muzeal, menaxherë, laborantë, etj.,), si dhe shpërndarjen e tyre të balancuar në funksion të zbatimit efektiv të objektivave të kësaj Strategjie. Në këtë drejtim, MKRS do të vazhdojë me përkrahjen sistematike në organizim të hulumtimeve shkencore, takimeve, debateve, konferencave, si dhe aktiviteteve kulturore dhe mediatike në fushën e trashëgimisë kulturore. Prioritet buxhetor do të ketë konsolidimi i teknologjive dhe aparaturës teknike për dokumentim dhe trajtim bashkëkohor të trashëgimisë kulturore si dhe trajnimi i punonjësve në përdorimin e tyre.

Veprimi orientues 5.3. synon vendosjen e kornizës për edukim të vazhdueshëm teorik dhe të praktikës profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore. Masë e rëndësishme në këtë drejtim është vendosja e bashkëpunimit afatgjatë dhe të strukturuar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për plotësim dhe zhvillim të kurikulave dhe edukim të gjeneratave të reja mbi trashëgiminë kulturore. Prioritet programor dhe afatmesëm i këtij bashkëpunimi do të jetë studimi, njohja, arkivimi, dokumentimi i praktikave dhe teknikave të artit tradicional, si dhe inkurajimi i ideve kreative, filantropisë dhe bamirësisë në trashëgiminë kulturore nëpërmjet diseminimit dhe përkrahjes së skemave të asociimit të anëtarësisë dhe të miqve të trusteeve, fondacioneve, shoqatave dhe klubeve, rregullimit të sponzorimeve dhe mbedhjes së fondeve dhe donacioneve.²⁵

²³ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Raportuesi Special në fushën e të drejtave kulturore (2011), Pika 5) mbi të drejtën për arsim thotë: "... është edukimi që lejon qasje në dije, vlera dhe në trashëgiminë kulturore." Shih më shumë në:

http://www.ohchr.org/Documents/Issues/CulturalRights/Summary_thematic_issues.doc

²⁴ Neni 6: "Drejt qasjes për të gjithë në diversitetin kulturor: Duke siguruar lëvizjen e lirë të ideve me fjalë dhe imazhe, duhet patur kujdes që të gjitha kulturat të mund të shprehen dhe ta bëjnë veten e tyre të njohur. Liria e shprehjes, pluralizmi medial, shumëgjuhësia, qasja e barabartë në art dhe në njohuritë shkencore dhe teknologjike, përfshirë edhe në formë digjitale, dhe mundësia për të gjitha kulturat që të kenë qasje në mjetet e shprehjes dhe diseminimit, janë garancitë e diversitetit kulturor."

²⁵ Në kuadër të orientimeve për Partneritet Publik Privat në Sektorin e Kulturës, UNESCO e vlerëson rolin e fondacioneve private në domenin e filantropisë kulturore krahas bamirësisë që mbetet aktivitet i dëshmuar që prej kohësh. Grantet e fondeve private sot janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe shpesh janë

6. HAPAT E ARDHSHËM PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Plani Orientues i Veprimit dhe politikat komplementare:

Plani Orientues i Veprimit është instrumenti kyç për operacionalizimin dhe zbatimin e Strategjisë. Ky dokument do të vehet në shqyrtim publik pas konsolidimit të rekomandimeve që do të mbledhen me rastin e konsultimit publik të këtij drafti të Strategjisë.

Plani Orientues i Veprimit të kësaj Strategjie konkretizon për secilin objektiv strategjik masat dhe veprimet orientuese, trupat koordinues dhe subjektet e definuara si institucione ose/dhe grupe ndër-institucionale/multisektoriale për zbatimin e tyre, afatet kohore dhe burimet materiale të nevojshme për zbatim, si dhe indikatorët e monitorimit të zbatimit.

Plani Orientues i Veprimit definon masat dhe veprimet që janë plotësisht apo pjesërisht pjesë e politikave dhe strategjive ekzistuese dhe të njejtat i kualifikon si:

- iv) të zbatueshme brenda afatit trevjeçar, me ç'rast merr si orientim Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2018 dhe vlerësimin e kornizave buxhetore sektoriale që do të përgatiten nga subjektet e përcaktuara si institucione/grupe përgjegjëse për zbatim;
- v) të zbatueshme brenda afatit dhjetëvjeçar të kësaj Strategjie, që do të definohen më tej nëpërmjet strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore në përputhje me kompetencat e tyre për planifikim dhe veprim strategjik sektorial;
- vi) me zbatueshmëri që shkon përtej afatit të kësaj Strategjie, e që përmbledh veprime të proceseve të vazhdueshme të cilat garantojnë integrimin e trashëgimisë kulturore në agjendat e zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, kulturor dhe social të Republikës së Kosovës. Në këtë kuadër, Strategjia duhet të kuptohet si një plan dinamik i hapur ndaj ndryshimeve, për t'iu përgjigjur kërkesave dhe pikëpamjeve në ndryshim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Bartës i zbatimit të Planit Orientues të Veprimit është MKRS, njësitë e saj organizative përgjegjëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe institucionet vartëse të saj, si dhe organet e tjera relevante qendrore, institucionet, agjencionet dhe institutet publike, komunat dhe organizatat e tjera.

kyçe në përkrahjen e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe qasjeve inovative të orientuara në rezultate dhe me dukshmëri të lartë. Shih më shumë seksionin “Public Private Partnerships in the Culture Sector” (2013). Në:

<http://www.unesco.org/nea/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/PublicPrivatePartnershipENG.pdf>

Financimi i aktiviteteve:

Zbatimi i Strategjisë do të financohet nga

- a) Buxheti i Kosovës, i cili mbetet burimi kryesor i financimit në fushën e trashëgimisë kulturore;
- b) fondet e buxhetit të qeverisjes komunale;
- c) fondet e IPA-s²⁶ dhe të programeve të BE-së (në këtë kuadër, është e rëndësishme që të fuqizohen kapacitetet absorbuese institucionale në të gjitha nivelet);
- d) donacionet dhe burimet e tjera vendore dhe ndërkombëtare të financimit;
- e) incentivat në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit kulturor që dalin nga programet sektoriale të ministrive të caktuara (MKRS, MTI, MZHE, MAPL, MASHT, etj.);
- f) të hyrat vetanake të institucioneve/aksionarëve dhe nga konsumatorët (tarifat e hyrjes në lokalitete të trashëgimisë kulturore, aktivitete turistike dhe hotelierike, shitja e suvenireve dhe materialeve promovuese, etj.);
- g) sponzorimet e veprimeve konkrete nga sektori privat i biznesit mbështetur në konceptin e përgjegjësisë korporative;
- h) alokimi i financave nga të gjithë pjesëmarrësit në zbatimin e Strategjisë, sipas aktiviteteve dhe pjesëmarrjes së tyre në planet specifike të veprimit.

Vlerësimi më i përafërt i burimeve financiare në dispozicion do të bazohet në një analizë të burimeve në dispozicion dhe burimeve të mundshme, si dhe planeve të veprimit. Për zbatim efikas, Strategjia përcakton krijimin e mekanizmave strukturor, siç është Fondi për intervenime emergjente, etj.

Buxhetet e përafërta për secilin objektiv do të pasqyrohen në Planin Orientues të Veprimit, dhe do të konkretizohen duke marrë për bazë:

- i) buxhetet e alokuara për veprimet/aktivitetet që janë pjesë e proceseve aktuale, të reflektuara pjesërisht në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2018, si dhe burimet financiare të siguruara nga mbështetjet strukturale financiare dhe donacionet;
- ii) buxhetet e nevojshme dhe afatet për sigurimin e tyre për veprimet/aktivitetet e reja që propozohen si të nevojshme për avancim të proceseve ekzistuese dhe zbatimin efektiv të objektivave të Strategjisë.

Mekanizmi për Monitorim të Zbatimit të Strategjisë:

Zbatimi i *Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2015-2025* varet në masë të madhe nga bashkëpunimi ndërinstitucional dhe shumësektorial, nga përfshirja e një numri subjektsh në zbatimin e masave dhe veprimeve, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm i proceseve dhe dinamikave të përcaktuara për çdo orientim strategjik. Në këtë funksion, kjo Strategji, e bazuar në nevojën për zbatim sistematik dhe të hapur, si dhe konform praktikave të mira, ordinaron krijimin e një Komiteti Monitorues për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore (KMZ-SKTK) 2015-2025, që për qëllim ka

²⁶ Në kuadër të IPA II, Kosova do të vazhdojë të përfitojë mbështetje nga asistenca e para-anëtarësimit gjatë periudhës 2014-2020.

monitorimin e progresit dhe kontrollin e veprimeve që çojnë në zbatimin e objektivave strategjike.

Ministri i MKRS me vendim të veçantë përcakton themelimin dhe përgjegjësitë e këtij Komiteti (monitorimi i progresit të zbatimit të planeve të veprimit, identifikimi i faktorëve të rrezikut në zbatim dhe të masave lehtësuese, përditësimi konform kërkesave të reja, organizimi i takimeve vjetore me publikun, pjesëtarë të komunitetit të trashëgimisë kulturore dhe palë të interesuara në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë, etj), si dhe sistemin e komunikimit dhe përgjegjësitë për raportim dhe monitorim të subjekteve të definuara si institucione ose/dhe grupe ndërinstitucionale, përgjegjëse për zbatimin e objektivave strategjike.

7. BIBLIOGRAFIA

Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016, Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Deklarata_E_politikave_Afatmesme_Prioritare_shqip.pdf

Deklarata e UNESCO-s për Diversitetin Kulturor (2001), Në: http://cif.icomos.org/pdf_docs/Documents%20on%20line/Heritage%20definitions.pdf

Dokumenti i UNESCO-s për inkuadrim të trashëgimisë kulturore në Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Prill 2013). Në: <http://www.unesco.org/neë/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/HeritageENG.pdf>

Dokumenti Strategjik Indikativ për Kosovën / Indicative Strategy Paper For Kosovo* (2014-2020). Në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-kosovo.pdf

Dokumenti strategjik i MKRS për Konservimin e Integruar, Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konzervimi_i_Integruar_ne_Kosove.pdf

Draft-Raporti i Parlamentit Evropian (mars 2015). “Drejt Qasjes së integruar në trashëgiminë kulturore në Evropë” (2014/2149(INI)). Në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+COMPARL+PE-546.783+01+DOC+PDF+V0//EN&language=EN>

EU/CoE Programi i Përbashkët: Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor (PCDK) (2012) Udhëzues për trashëgiminë kulturore. Mjete teknike për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë. Në: <https://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/Publications/Guidelines-ALB.pdf>

Karta e BE-së për Turizmin Kulturor (2007). Në: <http://www.alcornocales.org/gestor//images/cets/PDF/01OFFICIALTEXT.pdf>

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2018. Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Korniza_Afatmesme_e_Shpensimeve_2015_-_2017.pdf

Koichiro Matsuura, UNESCO (2003) Adresimi DG/2003/150, Në: http://www.un.org/esa/socdev/unpfii/documents/indigenousanday2008_UNESCO_en.pdf , dhe <http://whc.unesco.org/en/activities/488>

Konventa Evropiane për Peisazhet (2000). Në: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/176.htm>

Ligji nr. 02/I-88 për trashëgiminë kulturore. Në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>

Ligji nr. 04/I-174 për planifikimin hapësinor. Në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

Ligji nr. 04/I-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8990>

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Kosovën, Neni 108. Në: http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf

Orientimet Strategjike dhe Politikat e MKRS (2010). Prezentimi në: http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Prezentimi_MKRS_Maj_2010_-_Ministri_Haziri.pdf

Perspektiva e Zhvillimit Hapësinor Evropian Drejt zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të Bashkimit Evropian – ESDP (1999). Në: http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docoffic/official/reports/pdf/sum_en.pdf

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_Hapesinor_i_Kosoves_2010-2020_shq.pdf

Plani i Punës për Kulturë i BE-së (2015-2018). Në: http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.C_.2014.463.01.0004.01.ENG
[http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52014XG1223\(02\)&from=EN](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52014XG1223(02)&from=EN)

Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2006-2008

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018. Në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_2015-2018_10_mars.pdf

Procesi i Lubjanës në faqen zyrtare të Këshillit të Evropës në: https://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/see/irppsah/ljubljanaprocess_EN.asp

Public Private Partnerships in the Culture Sector (Partneriti Publik Privat në Sektorin e Kulturës) (2013), UNESCO. Në: <http://www.unesco.org/neë/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/PublicPrivatePartnershipENG.pdf>

Qasja në trashëgiminë kulturore (2011), Raport i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Raportuesi Special në fushën e të drejtave kulturore. http://www.ohchr.org/Documents/Issues/CulturalRights/Summary_thematic_issues.doc

Raporti i Progresit 2014 për Kosovën. Në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

Rekomandimi i UNESCOs për Peisazhin Historik Urban (Historic Urban Landscape-HUL); Rezoluta (2012) , ff. 50-55. Në: <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002150/215084e.pdf#page=52>

Strategjia e Evropës Juglindore 2020 për Punësim dhe Prosperitet në Perspektivën Evropiane - SEE 2020 . Në: <http://www.rcc.int/files/user/docs/reports/SEE2020-Strategy.pdf>

Udhëzimet Ndërkombëtare për Turizimin e Qëndrueshëm / International Guidelines for Sustainable Tourism. Në: http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13970&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE 2015-2025



Republika e Kosovës

Republika Kosova ~ Republic of Kosovo

Qeveria ~ Vlada ~ Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta ~ Ministry of Culture, Youth & Sport